

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Kronika 'zhvesh' trimat dhe nxjerr në shesh tradhtarët e Babos'/ Satira e Gjekmarkajt: Kush u fsheh poshtë tavolinës
ADRESA	https://piranjat.al/politike/kronika-zhvesh-trimat-dhe-nxjerr-ne-shesh-tradhtaret-e-babo-s-satira-e-g-i106296
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 12:29:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 12:26:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b92f3d076052293c79082c3729e66af3f3d51cc857eac963200f1a75b805a3db
TEKSTI	94ab0638763cc92fedb5af2e37422afc0bb7f78a815b1a89e53e2903ec575723
PAMJA	ba92eeb10e401121f559191e5bfede25d3c402c03262d5763a5b1b288c43bec5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cb81604d5cd3244566107e81af0e2037c3ac0b3b479cde926c22211e99f9a5fc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cb81604d5cd3244566107e81af0e2037c3ac0b3b479cde926c22211e99f9a5fc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

Shkodrës duke shkaktuar panik te

figura dhe grupe

ku gjate ditëve në vijim pritet të shpallë

- do mbahet mend se

te Edi Ramës në OKB

Shqipëri, diasporë

vetëm entuziazëm dhe gëzim te tifozët

mjeket neurologë

ne gjendje të lirë, ndërsa

Çësht është

[POLITIKE](#)

‘Kronika ‘zhvesh’ trimat dhe nxjerr në shesh tradhtarët e Babos’/ Satira e Gjekmarkajt: Kush u fsheh poshtë tavolinës

Nga Agron Gjekmarkaj Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 14:26



Kronika magjepset nga trimat dhe evidenton tradhtarët e Babos!

“Qyqja, moj nënë, qyqja, moj nënë,” u dëgjua mërmërima e Ekonomit kur pa Klodi Spaçin të veshur si vajzat me kordele të kuqe!

Kësaj i thonë: Babo digjet e Klodi krihet, i pëshpëriti Evisi te veshi, duke ia kapur xanxën.

Në fillim Zoti të merr mendjen, pastaj të tjerat avash-avash! Gaz Bardhi, ti merr të gjitha njëherësh! Erzlin të parin. Është bërë si xhebrailli, nga dosja del, në dosje hyn!

Tezja, qerratesha plakë, nuk bëri ish pa patur pula, u bë def, ç’më duhet mua, mendoi, Vlora me Gysin.

Ky i fundit, thonë që e paskësh thirrur për ta qortuar në zyrë për disa leje e gjëra në Jug dhe ajo ishte përletur! Aty i ka thyer zemrën. Ditmari bën be që ajo është e ndjeshme, se ia di hukamat e fshehtësisë dhe e ka vuajtur.

Sypetrit Malaj lëshonte vetëm krisma nga pas, bam-bum, bum-bam, prej stresit e frikës, aq sa Niko i tha: “Hallall bataretë e Opozitës, se nuk mbajnë erë, po ti paske ngrënë kërmë, more jezit, he të shplafte mortja, nuk paske patur një pikë mëshire!”

Stomaku i bënte zhurma si makinë korrëse!

Delina mbante një shami të lagur me uthull molle, si në protesta kur hedhin gaz lotsjellës! Sa e hiqte, lëshonte një pasthirmë sekellidie.

Ministri i Brendshëm. holi Demir Demo. hvri fshehurazi. sic i ka hiqe një trimi. dhe iku tinëz me krenari lenuri! Nuk lvnte telashe! Thonë do të dalë vetë me dvfek mbi sune. fustanelle veshur. hinur

mbi kalë, si Osman Gazepi dikur në Berat, për të bërë terbië krimin e organizuar.

Njeriu i trashë Gonxhe, (nga shëndeti më i gjerë se i gjatë, se nga mendja është birbo e allishverishexhi, edhe pse nuk di shkrim e këndim) bëri një xhiro me engjëlldisje mamuthi, sa për t’u dukur, dhe iku! “Ç’më duhet mua”, i tha në korridor, “jam me zemër të ngrirë, se më ka thirrur gjashtë herë Gysi te vendi.” I thuhej jo atij, he, i thuhej jo? Një ditë u rebelova, i bëra bisht: “Jam në Butrint.” “Po mirë”, më tha, “të pres kurdo të kthehesh.” Ç’të bëja, i shkova në mesnatë, pimë nga një gotë nga ajo vera e përfolur! E mirë ishte, të lëpije buzët.

Ata që kanë shkuar në studion e tij për të bërë hajër, për të ndërruar pozicionet, rrinin kokëulur si zaif dhe kishin të hequra barkut!

Nëpër dhëmbë, njeri tha: “Të bëjmë shoqatën ‘evleterit e Gysit’ dhe të mbrojmë njeri-jatrin nga telashet.” “Jo”, tha dikush, “ai ishte më i ri se ne. Qysh ne qenkemi bij, le ta quajmë ‘Besëlidhja e Shenjtë’.” Kështu u la! Ata që kanë ngrënë dacka abstenuan.

Vetëm Klosi doli të fliste si shyta (dhia që kërkonte brirët e humbi edhe veshët) e llomotiti mbyturazi nja dy-tre fjali, si ajo fërfërima nëpër poture! Pastaj, duke u tulatur dhe me marramendje, u ul në vend! Askush s’i tha: “Puna e mbarë!” Ca lëshuan llafe të liga, e ka nga pagjumësia, se vesi të punon qindin, helbete!

Seanca e të enjtes ishte surreale, gjithë namuzi i mazhorancës mbeti në dorë të Qefseres! “Fol”, i thanë Koçisë, “fol, beja fora, tregojë veten, ç’mund të bësh për Babon tonë në këto kohë zavallesh, se po të ishte Etilda këtu, e përmbyste bankën e drunj të qeverisë, si monumenti ‘Nënë Shqipëri’, do na printe?!”

“Jepi, ndizë”, i thanë Nufit, “lëshoji raketat e tua, shtypi butonat, tunde, more i paudhë, shkreve, digje, bëje zhari, falja dreqit gjithë ata edepsezër aty poshtë!!!” “Jo more, jam njeri i paqtë, jam i kalemit, i mendimit, arma ime është kultura”, tha dhe u fsheh nën tavolinë!

Pirro Dëngu e pa me përbuzje. “Po të isha unë aty, si dikur, tani sillja ushtrinë dhe i bëja zap, i zinin me duar dhe kjo mesele mbyllej me ballin lart, se ne kemi ngritur prapanicat e ulur kokën”, sot sokëlliu! Një lot sa një arrë i ra mbi dysheme!

“Thërrisni Karakaçin”, lëshuan kujen, “të vijë e të bëjë betejë, të luftojë si Oso Kuka, se na mbyti opozita”, këshilloi Bora, teksa vetë i frynte një pipeze!

“Eh”, tha Igli, “ku ta kapësh Enea Larasken (sipas dialektit të jugut, Karakaçe = larasce)!! Këmbët e lehta, faqja e bardhë, ai pastaj e ka zët të folurën.” “Po mbase luan gishtin”, insistoi Bora. “Eh, jo për këtë punë, bezani”, Igli, “po për atë tjetrën e vërtit!”

Në këtë mërzë e maraz, Shalsi, me lehtësinë e papërballueshme të qenies, nxori dy rriska bukë me gjalpë dhe me ca feta sallami brenda dhe i hëngri, si të ishte në një planet tjetër! Fërkoj edhe plëncin! Fatmir Xhafa, krejt si në këngën e Bregut “Thelleza që shkel mbi vese”, ashtu, pa u ndjerë si faraon, nuk u pa më.

Ju lutën Damos me lot në sy, motrani e shoqëni: “Fol, dil, se të bën Neta petulla ty, dil mbro Babon se pisk puna!” “Me qejf”, tha, “do ta bëja, po kam orarin e palestrës, Babo ka thënë mendje e shëndoshë në trup të shëndoshë, pastaj ai ka besim të Zeniqeja, jo tek unë, nuk e zhgënjëj dot, nuk ia kam prishur kurrë!!!”

I shihte Kostaqi qartë e më qartë dhe vuante thellë e më thellë. “Ah, të isha deputet aty, të shihnin ata zulleper, si i piqja në hell një nga një, si të ishin shelegë Lume”, dhe një damar ishte gati t’i dilte nga balli e të merrte arat si nafta që plas nga toka!

“Bah, mezallah”, tha Koçia pas një hezitimi të gjatë!

“Për këtë ditë të zezë kemi Qefseren”, e cila, e dalë si nga legjendat, çapitej mbi një fjalim të bërë hazër nga të tjerët!

Disa të shastisur shqiptonin si në jerm një fjalë të çuditshme: “Kartela, kartela”! Kidi, gjoja për ta mbrojtur, po sikur i nguli një kamë, tha: “Se ju jeni të pashpirtë, i kujtoni edhe lëndimin e damarëve!”

Braçja trokiti, si edhe herë të tjera, në dyert e kronikës! Ai pyeti: “Qysh e dini që Mamica me Taon vanë në konak të Babos?” “Na e ka thënë Babua vetë”, i thamë, “na e kërkoi si nder që të përhapim llafin që Mamica gjet rugën e Perëndisë dhe ju, trazovaçet e vegjël, të hidhni nga dora biçakët, boll bëtë lojëra luftërash!”

Braçja u skuq kur i konfidencuam se ty do të presë Qefserja për të bërë autokritikën, i shoqëruar nga Erjo Mile si dëshmitar, pa lule, pa llokume, pa portret. Pastaj ajo i shpie koncentratin! Ervin Hoxha pyeti Ogjin: “Të ngrihem t’u bëj gjëmën?” Ajo e ndali: “Rri, mbaj shënime e dorëzoi listën ‘Kronikës’, se nuk je ende gati pas traumave që ke pësuar! Ky është veprim më i dobishëm.”

Erjon Malaj u binte tëmthave me grushte – “Ç’më gjeti, ç’më gjeti” – ia dha piskamës!!! “Nuk flet askush, fshihen more”, u ankua. “Fol ti.” “S’do”, thotë njeri, “se më ka vdekur gjyshi vjet, kam përvjetorin, nuk më bën zemra.” “Fol ti”, i them tjetrit. “Mos ma kthe, kam parë ëndërr mbremë, sikur këputa gjuhën me dhëmbë dhe jam si pa qejf.” “Ti do llafosesh?” “Ah, jo, më ka pjellë pela në fshat, kam gëzim, ejani t’ju qeras!”

S’do askush e qante: “Ah, axha Tao, axha Tao, si më le vetëm në ditë të kiametit! U bëfsha tullac, u bëfsha, po ndeja me fillikat”, lebetitej!

Epo, Tao e vërtit llafin, qerratai i ka vënë syrin karriges së Nikollaqit! Pret tetorin. E pe edhe Babua, me gjithë dertet që e kanë kapluar, i kishte falur një buzëqeshje të madhe e bujare për të ilustruar diçiturën në Facebook, se ai paskësh çuar flamurin e Shqipërisë në selamet edhe me radar të fikur!

Askush mos pastë hallin e Bledion Nallbases!

Kishte rënë në një të madhe ndërzyzje! Shihte Mamicën me fustan blu e frynte bulçinjë, duke tërhequr një toskanelo, pako gjë, pako gjë e hajthme tepër, kerthi i fliste vetes! “Sikur e ka tkurrur Rutja!” Në mos tjetër, tha, “duhet fituar kjo betejë, ta kem atë fustan për ditën e gjykimit si qefin!” Termeja iu afrua e i tha: “Mbahu, vëlla, s’ia ka gjetur njeri fundin merakut, është pyll i pambarim! Lis pas lisi thyhet sëpata.”

Syri i keq i socialistëve, që atë natë me Babon që e keqyrën me babëzi, vështrimi i lig, kishte rënë mbi Jorushin e Tabakëve. Pantallonat e rinj, si kauboj, ishin çarë, për fat, afër këpucëve! Për e lëngata shkoi me aq dhe nuk ia ndali hovin!

Kryezëvendës Lideri, hyqymeti Flamur, komplimentoi “Kronikën” me fjalë të kursyera, pa yrrysh, të gjitha të peshuara, që ajo të thellohet në autokritikë, pa rënë në pesimizëm! Ndërkohë, Bernard Banushi, çiarçifi i toskërisë, thur plane të mëdha, tymi i të cilave do të dalë shumë shpejt mbi oxhak!

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 27 Shtator14:16

[Berisha udhëton drejt Strasburgut, pritet të zhvillojë takime me figura dhe grupe politike europiane](#)

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka udhëtuar drejt Strasburgut, ku gjatë ditëve në vijim pritet të zhvillojë n...

Nga Petrit Vasili POLITIKE 27 Shtator14:05

[Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet!](#)

Enveri përfundoi në Dullë dhe Rama në Ramzi, fundi i njëjtë mbetet! Asnjë shqiptar nuk mund të harrojë që g...

Nga Belind Këlliçi POLITIKE 27 Shtator13:56

[Fjalimi në OKB/ Këlliçi: Rama akuzoi shqiptarët për antisemitizëm - do mbahet mend se ktheu Shqipërinë në narkoshtet](#)

Miq të e mi, Ju froj të ndiqni një pjesë të fjalimit të Edi Ramës në OKB. Këtë fjalë zgjodhi Edi Rama ...

POLITIKE 27 Shtator13:50

[Stadiumi jehoi me thirrje kundër Ramës, Bardhi: Në Shqipëri, diasporë, sheshe e shkolla ka vetëm një thirrje, shporru!](#)

Fitoria e Shqipërisë ndaj Riellomosisë solli io vetëm entuziazëm dhe optimizëm të tifozët por u nërcollën edhe mesaz...

POLITIKE 27 Shtator10:31

[**Ish zv.ministri i Arsimit: Rama nuk u pranua në takimet e nivelit të lartë në New York**](#)

Ish-zv.ministri i Arsimit, Oltion Rrumbullaku ka komentuar qëndrimin e kryeministrit Edi Rama në Nju Jork, gjatë zhvillimit të punimeve t&...

POLITIKE 26 Shtator21:54

[**Kush e përgjodhi dhe verifikoi Vlora Hysenin? Ish-ministria socialiste, Meksi, reagon për skandalin e SHISH**](#)

Ish-ministria dhe ish-deputetja Ermelinda Meksi ka reaguuar përmes një postimi në Facebook lidhur me çështjen e Vlora Hysenit. Meksi ...

POLITIKE 26 Shtator21:47

[**Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasi pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet**](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t’u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

POLITIKE 26 Shtator21:15

[**Nga vezët e protestuesve te torta me flamingo, Rama batuta para diasporës në Nju-Jork**](#)

Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit me diasporën shqiptare në Nju-Jork, foli për një ndryshim në marrëdhënien mes ...

POLITIKE 26 Shtator19:48

[**“Brenda SPAK ka përplasje për Vlora Hysenin”, gazetari: Ai dhe një gjyqtar i GJKKO ka qenë në zyrën e Ergys Agasit**](#)

Prokurori i dosjes së AKSHI-t, Altin Dumani është në një konflikt me një prokuror të SPAK për llogari të dosjes s&e...

POLITIKE 26 Shtator19:01

[**“Nis mbledhja e firmave për referendum për bashki”/ Zhupa nga Ksamili: Kërkojmë të respektohet vullneti dhe nevojat e qytetarëve**](#)

Drejtesja politike e Partisë Demokratike për rrethin e Sarandës, deputetja Ina Zhupa, ka bërë të ditur nisjen e mbledhjes së...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 26 Shtator

[**Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptareve nga...**](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t’u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

AKTUALITET 26 Shtator

[**Autobusi përfshihet nga flakët në hyrje të tune...**](#)

Një autobus është përfshirë nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan. Për shkak të incidentit, rruga &e...

AKTUALITET 26 Shtator

[**Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit ...**](#)


Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të d...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[**Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!**](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.